



**KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME
NGA TRYEZA E RRUMBULLAKËT**

„Barazia në vendimmarrje dhe sigurimi i shërbimeve në nivel lokal:

Strategji për ndryshime „

E mbajtur në Shkup, 18 nëntor, 2015

42 aktiviste, hulumtuese dhe përfaqësuese të pushtetit lokal nga Maqedonija dhe Kosova, në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Shoqata për promovimin e barazisë gjinore Akcija Zdruzhenska, më 18 nëntor në hotel “ Impeksel 2” Shkup, debatuan për sfidat kyçe për gratë dhe drejtimit dhe strategjitë e mundshme për veprim me qëllim që të përmirësohet gjëndja dhe statusi i grave si dhe barazia në nivel lokal.

Tryeza e rrumbullakët ishte realizuar në kuadër të projektit “**Barazia dhe Përfaqësimi Gjinor Përtej Kufijve**”, i mbështetur nga BE në kuadër të IPA instrumentit për bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës. Projektin e realizon Akcija Zdruzhenska, në partneritet me Qendrën për studime gjinore të Kosovës, Institutit për zhvillim të komunitetit nga Tetova dhe Qendrës për këshillim dhe mbështetje të grave “Dora Dors” nga Prizreni.

Në tryezën e rrumbullakët ishin prezantuar rezultatet dhe rekomandimet e hulumtimit “**Gjëndja në lidhje me barazinë në vendimmarrje dhe promovimin e barazisë gjinore në rajonin e Pollogut**”, gjithashtu u shkëmbyen edhe të dhëna nga hulumtimi i gjëndjes në të njëjtat fusha në Kosovë.

Përveç rekomandimeve nga hulumtimi, në kuadër të diskutimit dolën edhe konkluzionet dhe rekomandimet gjenerale për veprim në drejtim të sigurimit të autonomisë dhe ndikimit më të madh të grave në vendimmarrje në nivel lokal dhe futjen/ingranimin e politikës sistematike dhe praktikës së vazhdueshme në NJVL për promovimin e barazisë gjinore.

1. Gratë, veçanërisht grupet e marginalizuara të grave janë pothuaj të përjashtuara nga proceset lokale të vendimmarrjes

Është e nevojshme një qasje proaktive e të gjithë aktorëve lokalë, qasje që do të mundësojë pjesëmarrje dhe ndikim të të gjitha grave, në çdo proces vendimmarrjeje dhe për të gjitha çështjet me rëndësi lokale.



Kjo nënkupton promovim publik më të madh të të drejtës së grave të vendosin për vete dhe për komunitetin, nxitjen e tyre ose ndërmjetësimin për shfrytëzimin e mekanizmave egzistues/proçese planifikimi dhe marrje vendimesh për prioritetet dhe shpërndarjen e resurseve, të cilat nga ana e tyre ndikojnë në kushtet në të cilat jetojnë, si dhe në gjëndjen dhe statusin e tyre në komunitet.

Gjithashtu, është e nevojshme të përshtaten/adaptohen dhe krijohen mekanizma specifikë dhe forma të përfshirjes aktive për gratë nga zonat rurale.

2. Vlerat patriarkale të shfaqura fort dhe rolet tradicionale të grave si nëna dhe amvise e kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në jetën sociale, politike dhe ekonomike në bashkësinë lokale.

Kjo kërkon zhvillim të qasjeve metodologjike hulumtuese, qasje që do t'i marrin parasysh normat gjinore, besimet, stereotipet dhe paragjykimet si objekt specifik shqyrtimi dhe hulumtimi dhe do t'a analizojnë mënyrën se si ato ndikojnë mbi gjëndjen në sfera të veçanta relevante për hartimin e politikave të institucioneve dhe aktorëve të tjerë.

Gjithashtu, është e nevojshme të hartohen/përgatiten programe dhe aktivitete të posaçme, veçanërisht nga ana e shoqatave të qytetarëve për ndryshimin e normave dhe bindjeve/besimeve tradicionale për rolet e grave dhe burrave, si një nga parakushtet bazë për arritjen e barazisë gjinore.

3. Mungesa e shërbimeve bazë që janë nën ingerencat e drejtpërdrejta të komunës, siç janë uji, energjia elektrike, transporti publik, kopshte për fëmijët, qendrat për personat me nevoja të veçanta, të moshuar dhe pleq, janë disa nga sfidat kyçe që e ngarkojnë më shumë përditshmërinë e grave, veçanërisht të atyre nga zonat rurale. Mungesa e këtyre shërbimeve, e bën të pamundur ndryshimin e roleve tradicionale të grave dhe e bën të pamundur realizimin e interesave të tyre ekonomike, sociale, politike dhe interesave të tjera.

Pushteti lokal duhet të fillojë me zhvillimin e kapaciteteve të veta për konstatimin dhe njohjen e problemeve të pabarazisë, të jenë proaktivë në identifikimin e nevojave specifike të grave, t'i përcaktojnë mënyrat e përshtatshme/adekuate për ofrimin e shërbimeve në mënyrë të tillë që siguron disponueshmëri tek kategoritë e ndryshme të grave, dhe shërbimet e tilla t'i vendosin si prioritet në programet dhe buxhetin e komunës.

4. Burimet financiare publike të kufizuara me të cilat disponojnë pushtetet komunale, veçanërisht ato më të voglat, theksohen si një nga sfidat kyçe për identifikimin e problemeve, planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve për t'u përballur me pabarazinë mes grave dhe burrave.

Është e nevojshme një qasje e gjithanshme multi-sektoriale ku çdo aktor do t'a ndërmer pjesën e vet të përgjegjësisë për promovimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore duke i pasur parasysh rolet e ndryshme specifike, mandatin dhe kompetencat. Autoritetet lokale e kanë përgjegjësinë më të madhe duke pasur parasysh obligimet ligjore dhe ingerencat si dhe resurset që u janë besuar në menaxhim.



Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian



Projekti është implementuar nga Akcija Zdruzhenska Shkup dhe Instituti për zhvillim të komunitetit Tetovë



Në të njëjtën kohë, si mundësi janë treguar/indicuar: Zhvillim i projekteve për shfrytëzimin më të madh të fondeve dhe mbështetjes të cilën e siguron pushteti qendror, BE dhe donatorët e tjerë për promovimin e shërbimeve relevante për gratë në bashkësitë lokale; Projekte për bashkëpunim ndërmjet komunave për tejkalimin e mungesës së shërbimeve lokale bazë.

Një nga mundësitë për aktivitet më të madh të autoriteteve lokale në drejtim të promovimit të barazisë gjinore është përfshirja e organizatave të grave në programimin e masave dhe aktiviteteve për promovimin dhe ngritjen në një nivel më të lartë të barazisë gjinore, si dhe realizimi i tyre nga ana e shoqatave të qytetarëve me mbështetje financiare nga buxheti lokal. Një qasje e tillë do të jetë në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë të aktiviteteve të shoqatave të qytetarëve të cilat punojnë në këtë fushë.

5. Aktivizmi lokal femëror si dhe veprimtaria e organizuar është pothuaj në zhdukje dhe nuk mundet t'u përgjigjet sfidave gjithnjë e më të mëdhaja të cilat dalin/ burrojnë nga diskriminimi i grave dhe nga pabarazia gjinore për shkak të kapacitetit të kufizuar dhe qasjes ndaj resurseve.

Si strategji të mundshme për tejkalimin e kësaj gjëndjeje ishin identifikuar: Fuqizimi i bashkëpunimit dhe bashkimit ndërmjet shoqatave të ndryshme të qytetarëve; Mbështetje reciproke në rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të organizatave dhe në realizimin e aktiviteteve; Implementimi i qasjeve kreative dhe/ose rrikthim tek praktikrat e deriatëhershme për mobilizimin dhe përfshirjen e grave; Zhvillimi dhe aplikimi i strategjive përfaqësuese/të avokimit të cilat njëkohësisht do të sigurojnë ndikim edhe mbi gratë edhe mbi institucionet, konsiderohen si mënyrë për një aktivitet më të madh të organizatave të grave. Si shumë i rëndësishëm është theksuar bashkëpunimi me gratë që janë në pozitë, pozitë nga e cila mund të kontribuojnë për një vëmendje më të madhe ndaj çështjes së barazisë në politikat dhe praktikën e autoriteteve vendore.

Në funksion të menaxhimit të sfidave në sferën e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore, është theksuar edhe nevoja e një bashkëpunimi ndërkufirat më të madh, nëpërmjet fuqizimit të lidhjeve, shkëmbimit të përvojës dhe praktikës dhe zhvillimit/ implementimit të projekteve të përbashkëta. Si një aspekt i rëndësishëm i të vepruarit theksohet promovimi dhe zbatimi i standardeve që burrojnë nga dokumentet relevante ndërkombëtare.



Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian



Projekti është implementuar nga Akcija Zdruzenska Shkup dhe Instituti për zhvillim të komunitetit Tetovë

